



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Burim Zeka	15.08.2023	26.08.2023	2023/0582

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 14.08.2023, **OE "K-ING" SH.P.K.** - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr.: 2023/0582, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **OE " INFRAPLUS " SH.P.K.** - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit në komunën e Fushe Kosovës në lagjen 28, 29, Bardh i Madh dhe Sllatine e Madhe"** me nr. të prokurimit: **"212-23-2115-5-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal MAPL.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **3,000.000.00 €**.

Fazat e procedurës së prokurimit:

Njoftimi për kontratë.....24.03.2023;

Procesverbali i hapjes së ofertave.....06.06.2023;

Njoftimi mbi vendimin e AK-së (i fundit).....25.07.2023;

Kërkesa për rishqyrtim31.07.2023;

Vendimi i AK-së në kërkesë për rishqyrtim.....02.08.2023;

Ankesa në OSHP.....14.08.2023;

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

AK gjatë zhvillimit të kësaj procedure ka shkelur këto dispozita:

- Neni 1 – Qëllimi
- Neni 7- Barazia në trajtim/Jo-Diskriminimi dhe transparencia
- Neni 13 - Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik
- Neni 56.3 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni 59- Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 69- Aftësia teknike dhe ose/ profesionale
- Neni 72 – Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë

- Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik 01/2023

Në bazë të ligjeve të Prokurimit në fuqi, nga data e publikimit lidhur me Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, MAPL, tutje identifikohet AK, datës: 25.07.2023, ne si Grup i operatoreve ekonomik në bazë të afateve ligjore kemi paraqitur Kërkesën për rishqyrtim pran Autoritetit Kontraktues, me datë 31.07.2023 kemi marrë “Përgjigjeje në kërkesën për rishqyrtim K-ING , dokumenti datë 02.08.2023 Ku në këtë rast AK nuk ka shpjeguar në detal kërkesat tona të pretenduara, bashkangjitur në këtë ankesë, përgjigjet e AK.

Pretendimi nr 1:

Si shkelje procedural në lidhje gjatë fazës së këtij aktiviteti të Prokurimit, procesi hapjeve të tenderit, Afati i fundit për dorëzim të ofertave sipas dosjes të tenderit (DT) ka qenë me datë 05.06.2023, ora 14:00:00 dhe hapja ofertave me datë 05.06.2023 ora 14:00.

Ndërsa hapja ofertave është dërgua me datë 06.06.2023, pas kërkesës tonë me email, ne nuk jemi njoftu për problemet që ka dhënë AK në vendimin kërkesën për rishqyrtim edhe pse dokumentacioni i bashkangjitur nuk shihen detalet e emailit drejtuar KRPP.

Kërkesa në dosje të tenderit në lidhje me afatin e fundit të dorëzimit të tenderëve dhe hapja e tenderëve.

	Vendi: Në platformën elektronike https://e-prokurimi.rks-gov.net
Hapja e Tenderit	Hapja e tenderit do të bëhet me 05.06.2023 14:00:00 Vendi: Ndërtesa e Ish Rilindjes kati 12 përmes platformës elektronike https://e-prokurimi.rks-gov.net

Pretendimi 2:

U sqaru se afati I fundit për dorëzim të ofertave sipas kërkeses së DT, me datë 05.06.2023, ndërsa ne kemi marrë Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me datë 25.07.2023, një shkelje procedural pa na njoftuar për nevojat rreth zgjatjes së afatit në lidhje me vendimin e AK.

Pretendimi 3:

Deklarat mbi fakte dhe argumente:

Me datën 27.07.2023, ora 15:31, në platformën E-prokurimit, kemi pranuar formularin B58, Njoftim për vendimin e AK, me të cilin nuk pajtohem fillimisht me arsyet e eliminimit tonë dhe poshtu me rekomandimin e një operatori ekonomik i cili është i papërgjegjshëm.

Në vijim i paraqesim faktet dhe argumentet tona lidhur me arsyet e eliminimit.

Në letren standarte të tenderuesit të eliminuar si arsye të eliminimit AK ka përmendur një reference e cila sipas AK nuk është leshuar Brenda periudhës së kërkuar në dosje të tenderit dhe rrjedhimisht sipas AK, nuk e plotësojmë kërkesën për 60% të vlerës së kontratave si lider.

Bazuar në dispozitat ligjore që përcaktohen në nenin 59 të LPP-së, vlerësimin e ofertave duhet ta bëni në përputhje me nenin si autoritet kontraktues, vlerësimin e ofertave duhet ta bëni në përputhje me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së, sepse në këtë paragraf thuhet: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Kërkesa në dosje të tenderit:

9.1.9 Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 9. - Kontrata të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, të përfunduara me Sukses gjatë 3 (tre) vitet e fundit, **deri në datën e publikimit të këtij Njoftimi të Kontratës.**

Vlerësimi I AK-së se nuk e plotësojmë kërkesën është në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 56 të LPP-së, sepse na keni eliminuar për një kërkesë e cila nuk ekziston në dosje të tenderit. Nga arsyetimi I KONTRATE, por kjo kërkesë nuk ekziston në dosje të tenderit as në njoftimet për korigjim/përmirësim të gabimeve të publikuara në platformën e E-Prokurimit.

Kërkesa e AK ka qenë shumë e qartë, sepse është kërkuar kontrata dhe referenca në tri vitet e fundit

DERI NE PUBLIKIMIN E NJOFTIMIT TE KONTRATES, që do të thotë deri me datën: 24.03.2023 dhe pranimi teknik sipas pretendimeve të AK se nuk përmbush kërkesën është e lëshuar me muajin shkurt, është dashur të merret parasysh sepse është Brenda kërkesës së përcaktuar në dosje të tenderit dhe po e përsërisim se kjo arsye e dhënë nga ana juaj është në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së

Pretendimi 4:

Sa i perket arsye së eliminimit që ka të bëjë me 1 (një) makinë për shpuarjen nëntokësore horizontale me system laserik të kontrollit deri në diametrin 500 mm., ku ju deklaroni se KENI OFRUAR MAKINEN PER SHPIM HORIZONTAL ME PJESE PERCJELLESE MARKA DITH ITCH JET TRACK TIP: 2720, E CILA NUK ESHTË NE PERPUTHJE ME KERESËN E AK-së.

Kjo arsye nuk qëndron se me një kërkim të thjeshtë në internet mund ta verifikoni se pajisja në fjalë është në përputhje të plot me kërkesën e dosjes së tenderit.

Konsiderojmë në këtë rast keni shkelur nenin 59 dhe 72 të LPP-së, sepse është dashur ta verifikojnë si AK, paraprakishtë para se të vendoset se a i plotëson specifikat teknike pasija në fjal apo jo.

Nese nuk eka pasur të qartë dokumentacionin e prezentuar, ju kishim ofru informata shtes, tek kjo maqineri me rëndësi të veçantë janë aksesorët se me cfar diametri do të realizohet shpimi, i bie që dimatri i shpimit caktohet në bazë të aksesorve shtes. Meqë në dosje të tenderit ka qenë tek kërkesa 5, teknike profesionale, AK të verifikoj në teren paisjet e ofruara, ne ju ftojmë që për makinerin e njëjt ta realizojm një shpim me diameter 500 mm, dhe ta heqni këtë dilem që nuk e kanë vërtetuar drejt.

Pretendimi 5:

Në vazhdim po i japim faktet dhe argumentet në lidhje me OE i rekomanduar për kontratë, i cili nuk plotëson kërkesat dosjës së tenderit ku AK ka kërkuar:

9.1 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

Kërkesa nr 2:

Kërkesa 2. Një Udhëheqës i Punimeve

Evidenca 2.

-Një kopje të noterizuar të diplomës diplomës (jo më e vjetër se 1 muaj), dhe një deklaratë të përgatitur dhe nënshkruar nga inxhinieri-udhëheqësi i punimeve, përmes së cilës inxhinieri deklarohej se do jetë i angazhuar në këtë projekt-kontratë;

-Një kopje të CV-së e nënshkruara nga vet ing.;

-Një kopje të kontratës ose para kontratës valide të punës; dhe
-Minimum një referencë si mbikqyres i projekteve të ngjashme

-Kontratë/a pune e cila dëshmon përvojën 5 vjeçare.

Kemi sqaruar këtë pretendim tek AK, në kërkesën për ri-shqyrtim, OE i rekomanduar ka propozuar për këtë kërkesë inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë – drejtimi hidroteknik, Z. Mirlind Kabashi, në bazë të qasjes së dokumentacionit dhe shoshitjes së tyre kemi vërejt se referencat janë të përgatitura sa për të përmbush njërën prej kërkesave, e cila ka qenë:

Minimum një referencë si mbikëqyrës i projekteve të ngjashme

OE I rekomanduar për Z. Mirlind Kabashi ka dorëzuar CV-në dhe referencat, mirpo as CV dhe referencat nuk dëshmojnë se Z. Kabashi ka realizuar mbikëqyrje sipas kërkesës së DT.

Kthehemi tek rregullorja 01/2022 të Prokurimit Publik dhe udhëzuesi 01/2023 Prokurimit Publik, në rastin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE i rekomanduar, për Z. Mirlind Kabashi CV- e dorëzuar nuk përmbush kërkeat – refuzo tenderin.

UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

10.1 *Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së*

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave të prezantuara	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
Lista e kontratave të realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar Dëshmitë (referenca/certifikata e pranimit/kontrata)	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
Mungon Certifikata e regjistrimit të biznesit	Mund të kërkohen informata sqaruese	66
Mungon Certifikata e TVSH	Mund të kërkohen informata sqaruese	66
Mungon Certifikata e numrit fiskal	Mund të kërkohen informata sqaruese	66
Mungon licenca	Mund të kërkohen informata sqaruese	66
Mungon certifikata ISO	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
Mungon çmimi	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar	Mund të kërkohen informata sqaruese	69

Se nuk ka relizuar asnje mbikqyrje të projekteve të ngjajshme, na jep me kuptu edhe referenca e lëshuar nga një OE FIDANI-L për Z. Kabashi-në:



REFERENCË

Datë : 20.01.2023

Me këtë reference “FIDANI L” SH.P.K e regjistruar me Nr Biznesi : 811990177, tregon se Zt.Mirlind Kabashi i lindur ne Gjakovë me 29.04.1964. është i punësuar ne ndërmarrjen tone si Inxhinier i Hidroteknikes.

Zt.Kabashi Është i angazhuar si Inxhinier ne kompaninë tonë nga data 01.01.2004 me kontratë pune.

Zt.Kabashi prej themelimit te marrëdhënies se punës ne kompaninë si menaxher i disa projekteve dhe udhëheqës i punishteve (mbikëqyrje) për projekte te kontraktuara nga kompania jonë:

AUTORITETI	EMRI I PROJEKTIT	VITI
------------	------------------	------


Nese shohim CV nuk ta të përshkruar asnje projekt për mbikqyrje të projekteve të ngjajshme, në paragrafin e tret të referencës se lëshuar me datë 20.01.2023 thuhet:

Zt. Kabashi prej themelimit te marrëdhënies se punës ne kompaninë si menaxher i disa projekteve dhe udhëheqës i punimeve (mbikqyrje) për projekte te kontraktuara nga kompania jonë:

Pra udhëheqës i punimeve nuk i bjen ekuivalente me mbikqyrje, janë të dy anë të ndryshme, e dëshmon edhe lista e kontratave që asnjera nga titujt në referencë nuk janë mbikqyrje, që rrjedhimisht dhe përfundimisht i bie që Z. Mirlind Kabashi nuk ka asnje kontrat të kompletuar në lidhje me kërkesën në DT të këtij Aktiviteti të prokurimit.

Dhe ku vie absurdi I përgjigjes në vendimin rishqyrtimit nga AK, dates 02.08.2023, në lidhje me këtë pretendim, ne kemi dhënë si shembull se si duket një tituli projektit në raste të mbikqyrjes së projekteve, ndërsa AK jepë përgjigje se ne nuk kemi kërkuar kontrat për mbikqyrje, kontrat e dimë që nuk ka kërkuar, mirpo ka kërkuar që stafi të ketë **Minimum një referencë si mbikqyrës i projekteve të ngjajshme**, sipas kërkesës së DT 9.1 kërkesa 2.

Kemi dhënë këtë shembull:



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada -Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije-
Ministry of Trade and Industry

KONTRATA

“Ministria e Tregtisë dhe Industrisë”, adresa Rr “Muharrem Fejza” p.n Lagja Spitalit
dhe “ K-ING” Sh.P.K. adresa Veternik II p.n , me NRB – 70676494-Prishtine –Avni Kuqi-Drejtor

janë pajtuar si në vijim:

TITULLI I KONTRATËS:

“ Mbikëqyrja e projektit : Ndërtimi i sistemit për furnizim me ujë Qendra e Panaireve ,Laboratori i Industrisë Kimike dhe Institutin e Produkteve te Ndërtimit “

Numri i Prokurimit: MTI204-12-144 -236

Neni 1 Ligji i zbatueshëm

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës,

Nuk kemi pretenduar se AK ka kërkuar në dosje të tenderit kontrat për mbikqyrje të projekteve, e dim dhe ne si OE kemi përmbush këtë kërkesë sipas DT kërkesa 2, e OE I rekomanduar për kontrat, respektivisht Z. Kabashi nuk ka asnjë projekt në cilësinë e mbikqyrësit, rrjedhimisht I bie që OE I rekomanduar nuk përmbush këtë kërkesë.

Pretendimi 6:

OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesën e DT në lidhje me planin dinamik, ku AK ka kërkuar:

9.1.6 Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 6.

OE duhet te dorëzon me Ofertën e tij, “Planin Dinamik të Detajuar”

Dëshmia 6.

Plani Dinamik - duhet të prezantohet sa më i detajuar i mundshëm (duke i përfshirë të gjitha aktivitetet (pozicionet) që janë të përfshira në paramana.

Dëshmia 6. Plani Dinamik - duhet të prezantohet sa më i detajuar i mundshëm **(duke i përfshirë të gjitha aktivitetet (pozicionet) që janë të përfshira në paramasa.**

Pasi e kemi pranuar oferten e OE të rekomanduar për kontratë, e kemi analizuar dhe fituesi ka ofruar plan dinamik për VETEM 40 POZICIONE, nga gjithsej 200 pozicione në paramasë, I bie që ka dhënë plan dinamik për 20% të pozicioneve të paramasës, pra fituesi nuk e plotëson këtë kërkesë sepse në dosje është kërkuar plan dinamik, ...**duke u përfshirë te gjitha aktivitetet (pozicionet) qe janë te përfshira ne paramasë.**

OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dhënë plan dinamik sipas kërkesës për pozicionet e paramasës.

Dhe në përgjigjen e pretendimit nr 5 nga AK, në kërkesën për rishqyrtim jep në këtë formë:

Vlen te theksohet se edhe ju si OE ne planin dinamik te dorëzuar me oferte keni deklaruar se “ne rast te nënshkrimit te kontratës do te dorëzoni planin dinamik te detajuar” prandaj vlerësojmë se pretendimi juaj ne këtë pike nuk qëndron dhe është i pa bazuar.

Në kuptimin logjik I bie qe “ qysh e ka bo bërlllog OE I rekomanduar e keni bërë edhe ju”, edhe pse kemi dhënë deklarat në lidhje palnin dinamik dhe në të njëjten kohe kemi dhënë plan dinamik për të gjitha pozicionet sipas kërkesës së DT.

Pretendimi 7:

OE i rekomanduar për kontratë, në oferten e tij e ka dorëzuar pajisjen për shpime horizontale dhe për të njejten ka dorezuar si deshmi një kontrate për qera e cila nuk eshte valide, sepse:

Kontrata eshte e lidhur me mes te Rcommerce construction dhe Infra Plusit, marreveshje e cila eshte NUL, sepse kjo pajisje është marrë me lizing në shtetin e Bullgarisë dhe në vecanti kjo pajisje sipas marreveshjes nuk guxon të nxirret jasht shtetit Bullgar, shih: Follderin nr. 17, makina për shpime horizontale,

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRESIT, FAQE NR 36, ku kufizohen te drejtat e qiramarresit, lidhur me perdorimin e makinerise në fjalë:

Neni 21. Qiramarrësi nuk ka të drejtë të:

- (1) të përdorë objektin e dhënë me qira në kushte ekstreme /si p.sh. pjesëmarrja në mitingje, për qëllime sportive, si mjet stërvitor, si taksi, etj./ dhe të manipulojë pajisjet e kontrollit dhe matjes së objektit të dhënë me qira. Qiramarrësi nuk ka të drejtë të ndryshojë vendbanimin/magazinin e sendit të dhënë me qira, përveçse me pëlqimin e shprehur paraprak me shkrim të QIRAdhënësit;
- (2) të shesë, hipotekojë ose të ngarkojë në ndonjë mënyrë tjetër sendin e dhënë me qira për kohëzgjatjen e kësaj kontrate, si dhe të bëjë ndryshime në sendin e dhënë me qira;
- (3) kryejnë veprime që do të zvogëlojnë vlerën e sendit të dhënë me qira;
- (4) t'u japë administrimin/përdorimin e sendit të dhënë me qira personave të paautorizuar prej tij; (5) t'i japë administrimin/përdorimin e sendit të dhënë me qira një personi të paafët

shofer me aftësi të kufizuara për llojin përkatës të objektit të qirasë

- (6) të lërë objektin e dhënë me qira jashtë kufijve të Republikës së Bullgarisë pa pëlqimin paraprak me shkrim të QIRAdhënësit. Pëlqimi konsiderohet i dhënë me dhënien e prokurës me nënshkrime të noterizuara, teksti i së cilës përfshin të drejtën e përdorimit të sendit jashtë vendit. Qiramarrësi siguron me shpenzimet e tij sendin e dhënë me qira me siguri ndaj rreziqeve të dëmtimit të

Sipas të drejtave të përcaktuara në këtë nen, operatori ekonomik nuk ka të drejtë ta nxjerr jashtë territorit të Republikës së Bullgarisë, rrjedhimisht OE i rekomanduar për kontrate, vetëm sa për të mbuluar kërkesën e dosjes së tenderit i ka dorëzuar këto dëshmi, e që nuk mund ta përdorë asnjëherë sepse në piken 6 të nenit 21 sanksionohet nxjerrja jashtë territorit të kësaj pajisje.

Pretendimi 8:

Pretendim tjetër është i rekomanduar për kontrate, ka dorëzuar certifikata të sladuesve në gjuhë jo zyrtare, pra jashtë gjuhëve ku një OE duhet të paraqes një ofertë, dhe që janë në kundërshtim me nenin 13 të LPP-së.

Schweißverfahren: Welding process:	Werkstoffgruppe: Material group(s):	Untergruppe subgroup
Heizelementstumpfschweißen	3 PE	3.4
Heizelementstumpfschweißen	3 PE	3.5
Heizwendelschweißen	3 PE	3.6
--	--	--

Detal nga dokumenti I dorëzuar nga OE, jashtë nenit 13 të LPP-së. Pra, dëshmia është në kundërshtim me nenin 13 të LPP-së. Pra, nuk kuptohet se për çfarë lloji të salldimit janë testuar.

Kërkojmë që shqyrtimi të jetë i barabart për palët, sipas nenit 7 të LPP-së, pa ndonjë anim miqësor apo interes tjetër dhe aktiviteti i prokurimit të rivlersohet në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim dhe ankesa jonë të aprovohet si e bazuar.

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP, nuk janë të njëjta.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	1. Qarkulli financiar nga një bankë e licencuar në vlerë prej 4,500 000.00 € në 3 (tri) vitet e fundit para datës së Njoftimit për Kontratë.	1. Raporti financiar nga një ose më shumë Banka.
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<p>Kërkesa 1.</p> <p>Operatori Ekonomik (Tenderuesi), me dokumentet e dorëzuara në ofertën e tij, duhet të vërtetoj se në resurset e veta njerëzore ka stafin si në vijim.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Një (1) menaxher të projektit inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik ose Master i shkencave hidroteknike me përvojë minimale prej 10 vite pas diplomimit dhe në menaxhimin e projekteve të ngjashme. 	<p>Evidenca 1.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Një kopje të noterizuar të diplomës (jo më e vjetër se 1 muaj), dhe një deklaratë të përgatitur dhe nënshkruar nga inxhinieri-menaxheri i projektit, përmes së cilës inxhinieri deklarohej se do jetë i angazhuar në këtë projekt-kontratë; -Një kopje të CV-së e nënshkruar nga vet ing. -Një kopje të kontratës ose para kontratës valide të punës; - Minimum tri referenca për menaxhimin e projekteve të ngjashme -Kontratë/a pune e cila dëshmon përvojën 10 vjeçare.
		<p>Kërkesa 2.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dy (2) udhëheqës të punimeve, Inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknik ose Master i shkencave hidroteknike , me përvojë minimale prej 5 vite pas diplomimit dhe në udhëheqje të punimeve të ngjashme. <p>Udhëheqësit e punimeve patjetër duhet të jenë INXHINIER TË DIPLOMUAR, APO MASTER TË HIDROTEKNIKËS</p>	<p>Evidenca 2.</p> <ul style="list-style-type: none"> -Një kopje të noterizuar të diplomës diplomës (jo më e vjetër se 1 muaj), dhe një deklaratë të përgatitur dhe nënshkruar nga inxhinieri-udhëheqësi i punimeve, përmes së cilës inxhinieri deklarohej se do jetë i angazhuar në këtë projekt-kontratë; -Një kopje të CV-së e nënshkruar nga vet ing.; -Një kopje të kontratës ose para kontratës valide të punës; dhe -Minimum një referencë si mbikqyres i projekteve të ngjashme -Kontratë/a pune e cila dëshmon përvojën 5 vjeçare.

		<p>Kerkesa 3.</p> <p>- Nje (1) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë;</p> <p>inxhinier i diplomuar i gjeodezisë ose Master i shkencave gjeodezise me përvojë minimale prej tri (3) vite pas diplomimit, gjithashtu te jete i licencuar nga AKK (Agjensioni Kadastral i Kosovës). - Dy (2) inxhinier bachelor i gjeodezisë, me përvojë minimale prej 3 vite pas diplomimit, gjithashtu te jete i licencuar nga AKK (Agjensioni Kadastral i Kosovës)</p>	<p>Evidenca 3.</p> <p>Një kopje të noterizuar të diplomës dhe licencës (jo më e vjetër se 1 muaj), dhe një deklaratë të inxhinierit të gjeodezisë (deklaratë, përmes së cilës inxhinieri deklarohet se është i angazhuar në këtë projekt-kontratë;</p> <p>- Një kopje të CV-së e nënshkruar nga vet ing.;</p> <p>- Një kopje të kontratës ose para kontratës valide të punës ose marrëveshjes së bashkëpunimit po ashtu valide.</p> <p>-Minimum tri referenca për projekte te ngjashme</p> <p>-Kontratë/a pune e cila dëshmon përvojën 3 vjeçare. - Certifikata qe është i licencuar nga AKK</p>
		<p>Kërkesa 4.-Tre (3) Saldues për gyp HDPE, të certifikuar sipas EN-13067.</p>	<p>Evidenca 4.</p> <p>Kopja e noterizuar e certifikatës së trajnimit e lëshuar nga një institucioni i autorizuar për trajnime të tilla. Një kopje të kontratës valide të punës ose marrëveshjes së bashkëpunimit po ashtu valide.</p>
		<p>Kërkesa 5.</p> <p>Operatori Ekonomik (Tenderuesi), me dokumentet e dorëzuara në ofertën tenderin e tij, duhet të vërtetoj se posedon pajisjet si vijon</p> <p>- 2 (dy) Eskavator minimum 20 ton</p> <p>- 2 (dy) Eskavator 9-18 ton</p> <p>- 2 (dy) Mini Eskavator nën 5 ton</p> <p>- 1 (nje) Luge ngarkuese, kapaciteti i</p>	<p>Dëshmia 5.</p> <p>Lista e mjeteve duhet të dorëzohet e skanuar nga origjinali - e nënshkruar dhe vulosur nga O.E.</p> <p>Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit me validitet ndërsa pajisjet tjera, OE duhet ti dëshmojë me një dokument për pronësinë e tyre (faturë, DUD etj.).</p>

		<p>luges 1m3</p> <ul style="list-style-type: none"> - 6 (gjashtë) Kamion minimum 12 ton pesha bartese - 3 (tre) Kamion min 3-4 ton nënkupton peshën bartëse të kamionit. - 1 (një) prerëse e Asfaltit, - 1 (një) makinë për shpuarjen nëntokësore horizontale me system laserik ose makinë shpuese pa llaser të kontrollit deri në diametrin 500 mm - 3 (tri) makina për saldim ballor - 3 (tri) makina për saldim elektrofuziv - 1 (një) Cilinder ngjeshës 4-5 ton - 2 (dy) Damper 2-4 ton - 3 (tri) makina ngjeshëse (papuqe) te dheut. - Rrethoja për sigurim te punishtes min 100m - Mbrojtëse kanali metalike min 25m` - 1 (një) Kompresor - Semafora sinjalizues mobil . 	<p>Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon ndonjë nga pajisjet e kërkuara, duhet te ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet te jetë në emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët.</p> <p>Vërejtje:</p> <p>Autoriteti Kontraktues mban të drejtën që të bëjë verifikimin e pajisjeve të ofruara. Në rast të mospërputhjes së të dhënave, OE do të eliminohet.</p> <p>Fotot për Rrethojën, mbajtëset metalike të kanalit, kompresorit dhe semaforëve sinjalizues</p>
		<p>Kërkesa 6.</p> <p>OE duhet te dorëzon me Ofertën e tij, “Planin Dinamik të Detajuar”</p>	<p>Dëshmia 6.</p> <p>Plani Dinamik - duhet të prezantohet sa më i detajuar i mundshëm (duke i përfshirë të gjitha aktivitetet (pozicionet) që janë të përfshira në paramana.</p>
		<p>Kërkesa 7.</p>	<p>Dëshmia 7.</p>

		OE duhet te dorëzon me Ofertën e tij, Planin e detajuar për Menaxhimin e trafikut.	Përshkrimi i planit për menaxhimin e trafikut i hartuar dhe i nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit.
		Kërkesa 8. Një (1) teknik të ndërtimtarisë ose komunikacionit mund të mbulohet me persona të kualifikuar si "Inxhinier i Ndërtimtarisë" apo "Inxhinier i Komunikacionit" me përvojë minimale prej 2 vite.	Dëshmia 8. Një kopje të noterizuar të diplomës (jo më e vjetër se 1 muaj) dhe një deklaratë ose para kontratë përmes së cilës deklarohet se është i angazhuar në këtë projekt-kontratë; - Një kopje të kontratës valide të punës ose marrëveshjes së bashkëpunimit po ashtu valide. - Minimum një referencë për projekte të ngjashme -Kontratë/a pune e cila dëshmon përvojën dy (2) vjeçare.
		Kërkesa 9. - Kontrata të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, të përfunduara me Sukses gjatë 3 (tre) vitet e fundit, deri në datën e publikimit të këtij Njoftimi të Kontratës, Vlera Totale e Kontratave të natyrës së punëve të ngjashme si të tilla mund të konsiderohen të gjitha referencat për punimet e infrastrukturës si Ujësjellës, Kanalizime, dhe Rrugë te jete min 4,000,000.00 Euro. - OE te ketë se paku 1,000,000.00 euro , mund të mbulohet me disa Referenca për punë të njëjta (Punime të rrjetave të Ujësjellësit).	Dëshmia 9. Lista e Kontratave të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, Listës së kontratave duhet ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet e pranimeve teknike për kontratat e prezantuara në listë.

		<p>Shënim</p> <p>Në rast të konzorciumit, udhëheqësi i grupit duhet të mbulojë së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë.</p>	
		<p>Kërkesa 10.</p> <p>Të paraqitet stafi që do të angazhohet në këtë projekt të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesional.</p> <p>– Stafi teknik (PUNONJËS) që do të kyçet në projekt -minimumi 20 punonjës, min 2 prej tyre te jene te certifikuar për Siguri dhe Shëndet ne pune.</p>	<p>Dëshmia</p> <p>10. Lista e punëtorëve me kontrata ose me Liste të ATK-së.</p> <p>Për dy punonjës me certifikatë te sigurisë mund të kenë edhe një kopje te kontratës; para kontratës ose marrëveshjes së bashkëpunimit po ashtu valide.</p>

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **“K-ING SH.P.K.”**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit në komunën e Fushë Kosovës në lagjen 28, 29, Bardh i Madh dhe Sllatinë e Madhe”** me numër të prokurimit: **“212-23-2115-5-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal MAPL**

Dokumenti	Grup i Operatorëve Ekonomik ILEAA - GR SH.P.K.; UNION RAKETA SHPK Dega në Kosovë	" Infra-Plus " SH.P.K.	Grup i Operatorëve Ekonomik K-ING SH.P.K.; HIDRO PROJECT SH.P.K.; Urban O.P.	ALFA.i - "Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit në komunën e Fushë Kosovës në lagjen 28, 29, Bardh i Madh dhe Sllatinë e Madhe"
	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim
Kërkesa 1. Operatori Ekonomik (Tenderuesi), me dokumentet e dorëzuara në ofertën e tij, duhet të vërtetoj se në resurset e veta njerëzore ka stafin si në vijim. - Një (1) menaxher të projektit inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik ose Master i shkencave hidroteknike me përvojë minimale prej 10 vite pas diplomimit dhe në menaxhimin e projekteve të ngjashme.	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim
Kërkesa 2. - Dy (2) udhëheqës të punimeve, Inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknik ose Master i shkencave hidroteknike , me përvojë minimale prej 5 vite pas diplomimit dhe në udhëheqje të punimeve të ngjashme;	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	I papajtueshëm
Kërkesa 3. - Nje (1) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë; inxhinier i diplomuar i gjeodezisë ose Master i shkencave gjeodezise me përvojë minimale prej tri (3) vite pas diplomimit, gjithashtu te jete i licencuar nga AKK (Agjensioni Kadastral i Kosovës). - Dy (2) inxhinier bachelor i gjeodezisë, me përvojë minimale prej 3 vite pas diplomimit, gjithashtu te jete i licencuar nga AKK (Agjensioni Kadastral i Kosovës)	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	I papajtueshëm
Kërkesa 4.-Tre (3) Saldues për gyp HDPE, të certifikuar sipas EN-13067.	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim
Kërkesa 5. Operatori Ekonomik (Tenderuesi), me dokumentet e dorëzuara në ofertën tenderin e tij, duhet të vërtetoj se posedon pajisjet si vijon - 2 (dy) Eskavator minimum 20 ton - 2 (dy) Eskavator 9-18 ton - 2 (dy) Mini Eskavator nën 5 ton - 1 (nje) Luge ngarkuese, kapaciteti i luges 1m3 - 6 (gjashtë) Kamion minimum 12 ton pesha bartese - 3 (tre) Kamion min 3-4 ton - 1 (një) prerëse e Asfaltit, - 1 (një) makinë për shpuarjen nëntokësore horizontale me system laserik,ose makinë shpuese pa llaser të kontrollit deri në diametrin 500 mm . - 3 (tri) makina për saldim ballor - 3 (tri) makina për saldim elektrofuзив - 1 (nje) Cilinder ngjeshes 4-5 ton - 2 (dy) Damber 2-4 ton - 3 (tri) makina ngjeshëse (papuqe) te dheut. - Rrethoja per sigurim te punishtes min 100m - Mbrojtese kanali metalike min 25m' - 1 (një) Kompresor - Semafora sinjalezues mobil .	I papajtueshëm	Në pajtim	I papajtueshëm	Në pajtim
Kërkesa 6. OE duhet te dorëzon me Ofertën e tij, "Planin Dinamik të Detajuar"	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim
Kërkesa 7. OE duhet te dorëzon me Ofertën e tij, Planin e detajuar per Menaxhimin e	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim
trafikut.				
Kërkesa 8. Një (1) teknik të ndërtimtarisë ose komunikacionit , me përvojë minimale prej 2 vite.	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim
Kërkesa 9. - Kontrata të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, të përfunduara me Sukses gjatë 3 (tre) vitet e fundit, deri në datën e publikimit të këtij Njoftimi të Kontratës, Vlera Totale e Kontratave të natyrës së punëve të ngjashme te jete min 4,000,000.00 Euro . - OE te kete se paku 1,000,000.00 euro referenca per ndertim te ujesjellesit . Shënim Në rast të konzorciumit, udhëheqësi i grupit duhet të mbulojë së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë.	Në pajtim	Në pajtim	I papajtueshëm	I papajtueshëm
Kërkesa 10. Të paraqitët stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesionalë. - Stafi teknik (PUNONJËS) që do të kyçet në projekt -minimumi 20 punonjës, min 2 prej tyre te jene te certifikuar për Siguri dhe Shëndet ne pune.	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim	Në pajtim

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale:

1. ALFA.i rr. Ibrahim Rugova pn., Lipjan 810298853

Kërkesa - 2 Për IDRIZ SHALA Mungonte kontrata e punës e cila dëshmon përvojën e punës 5 vjetarë sipas krekës së FDT –së, ne si AK dhe komision i vlerësimit në bazë të Rregullore Nr. 001 /2022 Për Prokurimin Publik dhe duke u bazuar në Neni 38 Sqarimi i Tenderëve me datën: 18.07.2023 kemi kërkuar sqarime përmes B47 Letrës Standarde Kërkesës për Sqarime e Tenderit dhe Ju si OE ALFA I jeni përgjigjur brenda afateve të përcaktuara, por në dokumentacioni e ofruar prapë nuk i keni sjellur/bashkangjitur dëshminë e kërkuar sipas DT-së,

Kërkesa -2 Për VETON JAHAJ Mungonte kontrata e punës e cila dëshmon përvojën e punës 5 vjetarë sipas krekës së FDT –së, ne si AK dhe komision i vlerësimit në bazë të Rregullore Nr. 001 /2022 Për Prokurimin Publik dhe duke u bazuar në Neni 38 Sqarimi i Tenderëve me datën: 18.07.2023 kemi kërkuar sqarime përmes B47 Letrës Standarde Kërkesës për Sqarime e Tenderit dhe Ju si OE ALFA I jeni përgjigjur brenda afateve të përcaktuara, por në dokumentacioni e ofruar prapë nuk i keni sjellur/bashkangjitur dëshminë e kërkuar sipas DT-së,

Kërkesa - 3 Operatori ekonomik nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e kërkuara në FDT sepse tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar një inxhinier i diplomuar i gjeodezisë (ose master) kurse OE Alfa I nuk e ka plotësuar këtë kriter sepse ka ofruar dëshmi për barcelor të gjeodezisë nga Universiteti i Prishtinës për z. Fisnik Loshi, ndërsa ka ofruar një dokument/diplomë të masterit të këtij personi, ku shkruan se z. Fisnik Loshi ka marr titullin si master i Teknologjisë që në Suedisht titullohet: Teknologjie masterexamen, ndërsa kur përkthehet në gjuhë shqipe rezulton se ky titull është Inxhinier i teknologjisë, kruese në diplomë në gjuhën angleze shkruan Degree of Master of Science. Po ashtu edhe në nostrifikimin e diplomës së masterit të këtij personi të dt.27.09.2023 me nr. 6/4-1641 të lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, nuk shkruan se ky person ka fituar gradën Master i Gjeodezisë por shkruan se është vetëm Master i Shkencës studime dy vjeçare dhe nuk shkruan se kjo diplomë përputhet me ndonjë program të gjeodezisë të Universitetit të Prishtinës, prandaj me këto dëshmi kuptohet që nuk është përmbush kërkesa e AK –së në lidhje me Nje (1) Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë; inxhinier i diplomuar i gjeodezisë ose Master i shkencave gjeodezisë.

Kërkesa 9. Kontrata të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, të përfunduara me Sukses gjatë 3 (tre) vitet e fundit, deri në datën e publikimit të këtij Njoftimi të Kontratës, Vlera Totale e Kontratave të natyrës së punëve të ngjajshme si të tilla mund të konsiderohen të gjitha referencat për punimet e infrastrukturës si Ujësjiellës, Kanalizime, dhe Rrugë te jete min 4,000,000.00 Euro. OE te ketë se paku 1,000,000.00 euro , mund të mbulohet me disa Referenca për punë të njëjta (Punime të rrjetave të Ujësjiellësit). Shënim, Në rast të konzorciumit, udhëheqësi i grupit duhet të mbulojë së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë.

Dëshmia 9. Lista e Kontratave të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, Listës së kontratave duhet ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet e pranimeve teknike për kontratat e prezantuara në listë.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “K-ING SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit në komunën e Fushë Kosovës në lagjen 28, 29, Bardh i Madh dhe Sllatinë e Madhe” me numër të prokurimit: “212-23-2115-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal MAPL

Ndërsa Operatori Ekonomik ka dorëzuar Listën e Kontratave të nënshkruar dhe të vulosur mirë-po-lista e kontratave dhe Referencave/raporteve nuk janë në harmoni nuk e përmbushin kërkesën sepse ka referenca/raporte të cilat janë lëshuar nga AK tjerë por janë si kontrata të pa përfunduara gjithë ashtu në listë OE ka prezantuar kontrata të cilat nuk kanë të bëjnë me kërkesën sipas DT-së referojuni kërkesë dhe dëshmisë së 9. Po i çekim kontratat për të cilat ka referenca pjesërisht të lëshuara kontrata të pa përfunduara si:

Titulli i projektit: “Dranazhimi, kanalizimi, ujësjellësi në Filologjik, FSHNM Filozofik” me numër të prokurimit: 242 -20-3990-5-1-1 për përfundimin e dy situacioneve të lëshuar në vlerë prej 905.000.00 € dhe “Rehabilitimi dhe mirëmbajtja kanalizimit & ujësjellësit” me numër të prokurimit: 622-19-4853-211 është e lëshuar vetëm për realizimin e punimeve deri me datën:11.07.2022 në vlerë prej 603.626.26 € ndërsa në listë është paraqitur në vlerë prej 1,084,375.00 dhe kjo kontratë është e pa përfunduar. Duke i parë këto të cilat i kemi çekur më lartë OE nuk e përmbushë këtë kërkesë.

2. Grup i Operatorëve Ekonomik ILEAA - GR SH.P.K.; UNION RAKETA SHPK Dega në Kosovë Rr. Mehmet Gradica Hyrja 6/2, Prishtinë

AK dhe komision i vlerësimit në bazë të Rregullore Nr. 001 /2022 Për Prokurimin Publik dhe duke u bazuar në Neni 38 Sqarimi i Tenderëve me datën: 18.07.2023 kemi kërkuar sqarime përmes B47 Letrës Standarde Kërkesës për Sqarime e Tenderit ndërsa OE ILEAA - GR SH.P.K.; UNION RAKETA SHPK nuk i ka ofruar fare dëshmitë e kërkuara sipas krekës, B47 dhe DT-së dhe kjo ofertë është e pa përgjegjshme për arsyeje sime poshtë .

Kërkesa 1 Tek Menaxheri i Projektit Selim Hyseni ka ofruar vetëm një referencë ndërsa është kërkuar minimum 3 referenca sipas FDT –së.

Kërkesa 2 Për AVDI ÇITAKU Mungonte kontrata e punës e cila dëshmon përvojën e punës 5 vjetarë sipas krekës së FDT –së, OE në ofertën e tij ka ofruar dëshmi vetëm për 3 cite përvojë pune.

Kërkesa 5 tek kërkesa në fjalë/dëshmia është kërkuar Në rast se OE nuk posedon ndonjë nga pajisjet e kërkuara, duhet të ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët ndërsa OE 2. Grup i Operatorëve Ekonomik ILEAA - GR SH.P.K.; UNION RAKETA SHPK nuk ka ofruar dëshmitë konform DT dhe B47 Letrës Standarde Kërkesës për Sqarime e Tenderit ndërsa andaj këtë pik nuk e përmbushë.

3. Grup i Operatorëve Ekonomik K-ING SH.P.K. HIDRO PROJECT SH.P.K.; Urban O.P. Kalabria Blloku A1 Llamella B K5/18, PRISHTINË

Kërkesa 5. Tek kjo kërkesë është kërkuar - 1 (një) - makinë për shpuarjen nëntokësore horizontale me system laserik ose makinë shpuese pa laser të kontrollit deri në diametrin 500 mm nders OE, K-ING SH.P.K. HIDRO PROJECT SH.P.K.; Urban O.P. ka ofruar një makinë e cila nuk është në harmoni me kërkesën e DT-së OE në fjalë ofron një makinë sipas DUD –it doganor nuk i plotëson kërkesat e AK –së Ju keni ofruar makinën për shpim horizontal me pjesë përcjellëse marka Dith Witch Jet Track Tip: 2720 e cila nuk është sipas kerkese së AK –së.

Kërkesa 9. Sipas kërkesë së AK –së në DT është kërkuar si kontrata të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, të përfunduara me Sukses gjatë 3 (tre) vitet e fundit, deri në datën e publikimit të këtij Njoftimi të Kontratës, Vlera Totale e Kontratave të natyrës së punëve të ngjajshme si të tilla mund të konsiderohen të gjitha referencat për punimet e infrastrukturës si Ujësjellës, Kanalizime, dhe Rrugë të jete min 4,000,000.00. Shënim, Në rast të konzorciumit, udhëheqësi i grupit duhet të mbulojë së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë. OE te ketë se paku 1,000,000.00 euro , mund të mbulohet me disa Referenca për punë të njëjta (Punime të rrjetave të Ujësjellësit).

Shënim

Në rast të konzorciumit, udhëheqësi i grupit duhet të mbulojë së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë.

Sipas listës të cilën e ka dorëzuar OE tek projekti me titull: Ndërtimi i një sistemi të furnizimit pijshëm për fshatrat e Rekës së Keqe dhe Luginës së Carragojës Komuna e Gjakovës në financuar nga Community Development Initiatives – CDI vlera e së cilës është: 500,199.75 € dhe data e kompletimit të projektit është: 25.02.2020 si dhe keni ofruar një Raport i cili i ka pranuar punët me datën: 25.02.2020, dhe i cili nuk është në harmoni me kërkesat tona dhe është projekt jashtë periudhës të caktuar 3 vjeçare, dhe Ju si lider i grupit K-ING SH.P.K. nuk e përmbushni/mbuloni 60% të referencave të kërkuara më lartë sipas DT-së.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - " **K-ING " SH.P.K.**

Përgjigje në Pretendimin Nr.1:

Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te bëjë me publikimin e procesverbalit të hapjes së ofertave eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja në përgjigjen në kërkesën për rishqyrtim të OE ankues ka bashkangjitur komunikimin përmes emailave me helpdeskun brenda KRPP në bazë të të cilit ka dëshmuar se ka probleme me hapjen e ofertave.

Në këtë rast AK-ja ka vepruar në përputhje me nenin **Neni 35 Hapja e Tenderëve elektronik paragrafi 35.12**

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi për këtë pikë i OE ankues **nuk është i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin Nr. 2:

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim nuk ka qenë pjesë e pretendimeve në kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar pranë AK-se e cila rezulton se nuk është në përputhje me nenin 13 të RRP se OSHP pika 9.

Lidhur me këtë pretendim RRPP 001/2022 neni 40.3 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh.

Procesverbali i hapjes së tenderit ka qenë me datën 05.06.2023 ndërsa vlerësimi ka përfunduar me datën 24.07.2023. Vlerësimi i AK-se ka qenë brenda afatit të definuar me rregullore por qe AK-ja nuk ka bashkangjitur në sistemin e e-prokurimit ndonjë arsyetim mbi zgjatjen e afatit të vlerësimit.

Prandaj bazuar në sqarimet si më lartë pretendimi ankimor **është pjesërisht i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin Nr. 3:

Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka të bëjë me kërkesat sipas nenit 9.1 & 9.2 eksperti shqyrtues

sqaron se sipas dosjes se tenderit kërkesa është:

Kërkesa 9.

- Kontrata të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, të përfunduara me Sukses gjatë 3 (tre) vitet e fundit, **deri në datën e publikimit të këtij Njoftimi të Kontratës,**

Vlera Totale e Kontratave të natyrës së punëve të ngjashme si të tilla mund të konsiderohen të gjitha referencat për punimet e infrastrukturës si Ujësjellës, Kanalizime, dhe Rugë te jete min 4,000,000.00 Euro.

Shënim

Në rast të konzorciumit, udhëheqësi i grupit duhet të mbulojë së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë.

Dëshmia 9.

Lista e Kontratave të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, Listës së kontratave duhet ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet e pranimeve teknike për kontratat e prezantuara në listë.

OE ankues në listën e kontratave të dorëzuara me ofertë ka dorëzuar 11 kontrata. AK-ja gjatë vlerësimit ka pranuar 10 prej tyre derisa nuk e ka pranuar kontratën me nr. rendor 1 e cila është e evidentuar si e kompletuar me datën **25.02.2020**. Ne bazë të njoftimit mbi eliminimin e OE ankues, lista e kontratave të dorëzuara nuk e plotëson kriterin e kërkuar që **“lideri te mbuloje 60% te referencave”**.

Sipas UOPP neni 8 pika iii) Në të gjitha rastet e përfshira në 2.1, 4.2 dhe 6.2 të nenit 69 të LPP-se përmendet shprehja si në vijim citojmë: **“ të realizuara (përfunduara) në tri vitet e shkuara “ose “ në periudhën e shkuar trevjeçare...”**). Ne kuptimin e Ligjit shprehja **“tri vitet e shkuara”** nënkupton: “ periudhën kohore të përcaktuar ne këto nene e cila ndërlidhet me periudhën që paraprinë datën e publikimit të njoftimit për kontrate.

- Ne kuptim të nenit 69 paragrafi 2.1, 4.2 dhe 6.2 shprehja “.....te realizuara ne tre vitet e shkuar” nënkupton **Kontratat për furnizime, shërbime dhe/ose pune të realizuara** (përfunduar) ne periudhën e shkuar tre vjeçare (periudha e sqaruar si me lart).

Sipas dosjes se tenderit publikimi i njoftimit për kontrate është bere me datën 24.03.2023. Definimi sipas UOPP “Ne kuptimin e Ligjit shprehja **“tri vitet e shkuara”** nënkupton: “ periudhën kohore të përcaktuar ne këto nene e cila ndërlidhet me periudhën që paraprinë datën e publikimit të njoftimit për kontrate”, Kjo nënkupton se AK gjatë vlerësimit te listës se kontratave te dorëzuara me ofertën e OE ka vepruar ne përputhje me UOPP dhe LPP-ne.

Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm	69
--	--	----

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues në këtë pike **nuk është i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin Nr. 4:

Lidhur me pretendimin ankimor të OE që ka të bëjë me kërkesën 5 - 1 (një) makinë për shpuarjen nëntokësore horizontale me sistem laserik ose makinë shpuese pa llaser të kontrollit deri në diametrin 500 mm

Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmojnë me librezën e regjistrimit me validitet ndërsa pajisjet tjera, OE duhet ti dëshmojë me një dokument për pronësinë e tyre (faturë, DUD etj.).

Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon ndonjë nga pajisjet e kërkuara, duhet të ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.

Eksperti shqyrtues sqaron se me ofertë OE ankues ka dorëzuar DUD doganor me përshkrim të pajisjes Ditch Witch JT 2720. Në DUD nuk ka përshkrim se pajisja e njëjtë është në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit.

OE ankues në kërkesën për rishqyrtim dhe në ankesë në pretendimin e tij i referohet se “me kërkesë të thjeshtë në internet mund të verifikohet lehtë” por nuk ka bashkëngjitur asnjë dëshmi që të vërtetojë pretendimet e tij apo webfaqe në të cilën e ka verifikuar të njëjtën.

Prandaj në këtë rast eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues nuk ka plotësuar kërkesat sipas nenit 26.8 pika 3 c) kriteret minimale të kualifikimit.

AK-ja në këtë pikë ka vepruar në përputhje me nenin 59 paragrafi 4 lidhur me nenin 40.6 pika b), c) .

Prandaj bazuar në sqarimet e dhëna më lartë eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor **nuk është i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin Nr. 5:

Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me inxhinierin M.K të OE të rekomanduar për kontratë në lidhje me kërkesën 2 **Kërkesa 2.**

- Dy (2) udhëheqës të punimeve, Inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknik ose Master i shkencave hidroteknike , me përvojë minimale prej 5 vite pas diplomimit dhe në udhëheqje të punimeve të ngjashme.

Evidenca 2.

-Minimum një referencë si mbikëqyrës i projekteve të ngjashme

Pretendimi i OE ankues në këtë pikë është se inxhinieri nuk e plotëson kërkesën për “**minimum një referencë si mbikëqyrës i projekteve të ngjashme**”.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja në bazë të dosjes së tenderit ka kërkuar që kërkesa 2 të dëshmohej me “**referenca**”. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar dy referenca në emër të

inxhinierit nga OE Fidani AL dhe AK Komuna e Gjakovës. Sipas referencave:

REFERENCË

Datë : 20.01.2023

Me këtë reference "FIDANI L" SH.P.K e regjistruar me Nr Biznesi : 811990177, tregon se Zt.Mirlind Kabashi i lindur ne Gjakovë me 29.04.1964. është i punësuar ne ndërmarrjen tone si Inxhinier i Hidroteknikes.

Zt.Kabashi Është i angazhuar si Inxhinier ne kompaninë tonë nga data 01.01.2004 me kontratë pune.

Zt.Kabashi prej themelimit te marrëdhënies se punës ne kompaninë si menaxher i disa projekteve dhe udhëheqës i punishteve (mbikëqyrje) për projekte te kontraktuara nga kompania jonë:



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Me kërkesën e Ing.Afrim Brovina dhe te OE NTP FIDANI L me seli ne Baballoq/Deçan ,
Drejtoria për Sherbime Publike e Komunës se Gjakoves , leshon këtë:

REFERENCË

Me këtë konfirmojme se Ing.hidro. Mirlind Kabashi ne kuader te kompanise NTP FIDANI L , ka menaxhuar – realizuar disa projekte per Komunen e Gjakoves.

Titujt e projekteve : Ndertimi i kanaleve te ujitjes ne zonat rurale , Ndertimi dhe sanimi i rrugeve me kubeza betoni dhe graniti , Ndertimi i rrugeve me kubeza betoni – Lot I , Renovimi i disa shkollave.

Bazur ne raportin e organit mbikëqyrës , i cili i ka percjellur punimet e OE FIDANI L dhe projekt menaxherit te kompanise ne fjale Ing.hidro.Mirlind Kabashi i cili ka kryer mbikëqyrur punimet sipas standarteve teknike ndertimore per te gjitha projektet e lartecekura.

Referencat e bashkangjitura janë në përputhje me kërkesën e AK-se për mbikëqyrje të projekteve. AK-ja në përgjigjen ndaj pretendimit te OE ankues ku i referohet si shembull: kontratës se mbikëqyrjes me Ministrinë e Tregtisë më të drejtë e ka vlerësuar se kërkesa e dosjes se tenderit është qe Mbikëqyrja te dëshmohej me referencë për inxhinierin dhe jo për subjektin juridik (OE). Prandaj Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja gjatë vlerësimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë në këtë pikë ka vepruar në përputhje me nenin 59 te LPP-se.

Prandaj duke u bazuar në sqarimet e mësipërme eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi **nuk është i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin Nr. 6:

Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me planin dinamik të OE të rekomanduar për kontratë eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa e dosjes së tenderit është:

Kërkesa 6. OE duhet të dorëzon me Ofertën e tij, “Planin Dinamik të Detajuar”

Dëshmia 6. Plani Dinamik - duhet të prezantohet sa më i detajuar i mundshëm (duke i përfshirë të gjitha aktivitetet (pozicionet) që janë të përfshira në paramasa.

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar vetëm 40 pozicione nga 200 pozicionet të paramasës.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar planin dinamik për 151 pozicione.

Në pozicione janë të përfshira të gjitha aktivitetet që janë pjesë e paramasës dhe para llogarisë pjesë të dosjes së tenderit.

Pjesa që nuk janë përfshirë kanë të bëjnë me nën pozicione për furnizime të cilat janë pjesë e aktiviteteve të përfshira në planin dinamik.

Vlen të theksohet se afati i përfundimit të planit dinamik nuk ka ndryshuar që dtth se aspektet materiale të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë nuk janë prekur.

Për më tepër dosja e tenderit nën 12.1 i KVK e përcakton se plani dinamik është dokument që duhet të azhurnohet pra është kusht kontraktual.

Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi për këtë pikë mund të kualifikohet si “devijim i vogël” në përputhje me Nenin 59.4 pika ii) të LPP-së lidhur me nenin 45.19 dhe 45.20 të RPPP

Prandaj duke u bazuar në sqarimet e dhëna eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi **është pjesërisht i bazuar.**

Përgjigje në Pretendimin Nr. 7:

Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me makinën e shpimit dhe kushtet e kontratës së shfrytëzimit të makinës dhe konstatimin se “pajisja nuk guxon të nxirret jashtë shtetit Bullgar” eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë me ofertën e tij ka dorëzuar marrëveshjen për shfrytëzim me qira me **OE RAICOMMERCE.**

Sipas marrëveshjes

(6) të lërë objektin e dhënë me qira jashtë kufijve të Republikës së Bullgarisë pa pëlqimin paraprak me shkrim të QIRAdhënësit. Pëlqimi konsiderohet i dhënë me dhënien e prokurës me nënshkrime të noterizuara, teksti i së cilës përfshin të drejtën e përdorimit të sendit jashtë vendit. Qiramarrësi siguron me shpenzimet e tij sendin e dhënë me qira me siguri ndaj reziqeve të dëmtimit të përcaktuara nga QIRAdhënësi dhe në një Sigurues të përzgjedhur nga QIRAdhënësi dhe të miratuar nga QIRAdhënësi për periudhën e qëndrimit jashtë vendit, QIRAdhënësi ka të drejtë sipas gjyqimit të tij të kërkojë dhe të marrë një garanci të mjaftueshme për shumën e kësteve të qirasë që mbeten për t'u paguar sipas kontratës, për të dhënë pëlqimin, si dhe për të refuzuar lëshimin e prokurës së noterizuar, në rast se QIRAmarrësi është në vonesë për më shumë se dhjetë ditë detyrime që paguhet në bazë të kësaj ose një kontrate tjetër (përfshirë detyrimet e prapambetura sipas kontratave, sipas QIRAMARRËSIT është palë si Debitor përbashkët ose ka siguruar detyrimet si Garantues) të lidhura ndërmjet QIRËMARRËSIT dhe njëres prej shoqërive të mëposhtme "UNICREDIT LEASING" AD me EIK 121887948, "UNICREDIT AUTO LEASING" EOOD me EIK 131081001, "HI BI LEASING" OOD me EIK 131128312, "HC WEB AUTO LEASING" EOOD me EIK201121" 61857, "BULBANK AUTO LEASING" EOOD me EIK 131157716, "BA KREDITANSTALT BULUS" EOOD me EIK 131062620;

Marrëveshja e qirasë neni 21 paragrafi 6

(6) të lërë objektin e dhënë me qira jashtë kufijve të Republikës së Bullgarisë pa pëlqimin paraprak me shkrim të QIRAdhënësit. Pëlqimi konsiderohet i dhënë me dhënien e prokurës me nënshkrime të noterizuara, teksti i së cilës përfshin të drejtën e përdorimit

Pra sipas marrëveshjes pajisja mund të shfrytëzohet edhe jashtë vendi nëse merret pëlqimi paraprak. Është obligim i OE të rekomanduar për kontratë që të marrë pëlqimet e nevojshme pas nënshkrimit të kontratës.

Eksperti shqyrtues në këtë pikë vlerëson se kërkesa e dosjes së tenderit është përmbushur derisa pretendimi i OE ankues është subjekt i mos përmbushjes së kushteve kontraktuale në mes të dy palëve kontraktuese.

Prandaj bazuar në dokumentet e administruara për këtë pretendim eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor **nuk është i bazuar**.

Përgjigje në Pretendimin Nr. 8:

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim nuk ka qenë pjesë e pretendimeve në kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar pranë AK-se e cila rezulton se nuk është në përputhje me nenin 13 të RRP se OSHP pika 9

Lidhur me këtë pretendim eksperti shqyrtues sqaron se në bazë të dosjes së tenderit pika Kërkesa 4.

-Tre (3) Saldues për gyp HDPE, të certifikuar sipas EN-13067.


Evidenca 4.

Kopja e noterizuar e certifikatës së trajnimit të lëshuar nga një institucioni i autorizuar për trajnime të tilla.


OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar certifikatat EN13067

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “K-ING ” SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit në komunën e Fushë Kosovës në lagjen 28, 29, Bardh i Madh dhe Sllatinë e Madhe” me numër të prokurimit: “212-23-2115-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal MAPL

<p>Schweißer Prüfbescheinigung: Welder's Qualification Test Certificate:</p> <p>Name des Schweißers: Welder's name:</p> <p>Legitimation/ Art der Legitimation: Identification/Type of Identification:</p> <p>Geburtsdatum: Date of birth:</p> <p>Beschäftigt bei: Employer:</p>	<p>Kunststoffschweißer gemäß ÖNORM EN 13067:2013</p> <p>Avdi Musliu</p> <p>ID-Card / 1004035204</p> <p>27.10.1980</p> <p>Diamanti Prishtina</p>	<p>Schweißerzeichen: Welder's mark:</p> <p>WPS-Referenz Nr.: WPS-Reference-No.:</p> <p>Zertifikatsnummer: Certification-No.:</p> <p>Vorschrift/Prüfnorm: Code/Testing Standard:</p>	<p>AM2</p> <p>22AIE032-22AIE034</p> <p>SWKU22INT0009- SWKU22INT0011</p> <p>ÖNORM EN 13067:2013</p>
---	--	---	--



<p>Prüfstelle: <i>Examining body:</i></p> <p>Prüfer: <i>Examiner</i></p> <p>Zweitprüfer <i>Second Examiner</i></p> <p>Datum des Schweißens: <i>Date of welding:</i></p> <p>Verlängerungsmodus gem. <i>Type of prolongation acc.</i></p> <p>Gültig bis²⁾: <i>Validity of approval until²⁾:</i></p> <p>Ort/Datum der Ausgabe: <i>Location and Date of issue:</i></p>	<p>WIFI Zertifizierungsstelle</p> <p>Josef Füreder</p> <p>23.03.2022</p> <p>ÖNORM EN 13067 (13.2)</p> <p>23.03.2024</p> <p>WIFI-Linz / 19.04.2022</p>
---	---



Eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa e dosjes se tenderit është qe të dëshmohet standardi i certifikimit EN-13067 dhe jo “**procesi i saldimit**” prandaj vlerëson se dokumentet e dorëzuara me ofertë janë ne përputhje me kërkesat e dosjes se tenderit.

Prandaj duke u bazuar ne sqarimet e dhëna me lartë eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi **nuk është i bazuar.**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **“" K-ING " SH.P.K.”**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **““Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit në komunën e Fushë Kosovës në lagjen 28, 29, Bardh i Madh dhe Sllatinë e Madhe””** me numër të prokurimit: **“212-23-2115-5-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal MAPL**

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe **të mbetet në fuqi vendimi i AK.**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**" K-ING " SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**“Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit në komunën e Fushë Kosovës në lagjen 28, 29, Bardh i Madh dhe Sllatinë e Madhe”**” me numër të prokurimit: “**212-23-2115-5-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal MAPL**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal MAPL**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **" K-ING " SH.P.K.**

Burim Zeka

